| **Buletini Nr. 15/ 2024, 15-01-2024** | **Parashikimi** nga 15-01-2024, ora 12:00 deri 16-01-2024, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI METEO

**----------------------**

### RESHJET

Sot pasdite (e hënë, dt.15) dhe nesër (e martë, dt.16) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive shoqëruar me shtrëngata në qarqet Shkodër dhe Kukës. Në qarqet Dibër, Lezhë, Durrës dhe Tiranë priten reshje mesatare, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare (siç tregohet në  tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në zonat malore në Veri dhe Verilindje të vendit, në lartësitë mbi 800m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve për momente të shkurtra mund të krijojnë probleme të ndryshme si dhe vërshime të ujit në zonat urbane në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër dhe Kukës.

### TEMPERATURA

Nesër (e martë, dt.16) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 10 / 15 °C

në vendet e ulëta: 9 / 14 °C

në vendet malore: 3 / 9 °C

### ERA

Sot pasdite (e hënë, dt.15) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë, kryesisht në bregdet, ndërsa nesër (e martë, dt.16) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LARTË** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive |  | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 15 – 16.***

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
|  | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
|  | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
|  | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
|  | Rrëshqitje toke |